

VENDIM
NR. 1020, DATË 16.12.2020

**PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMISIONIT TEKNIK
KËSHILLIMOR PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NDAJ FATKEQËSIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nën drejtimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (në vijim “KTK”), i cili këshillon për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile.

2. KTK-ja kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe ka në përbërje përfaqësues të ministrive, të strukturave në varësi të tyre dhe të institucioneve, si më poshtë vijon:

- a) Ministria e Mbrojtjes;
- b) Ministria e Brendshme;
- c) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- ç) Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- d) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- dh) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- e) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- ë) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- f) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- g) Ministria e Drejtësisë;
- gj) Ministria e Kulturës;
- h) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- i) Drejtoria për Çështjet Vendore dhe Prefekturat;
- j) Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit;
- k) Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin;
- l) Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (me ftesë);
- ll) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;
- m) Instituti i Shëndetit Publik;
- n) Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (me ftesë);
- nj) Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;
- o) Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH);
- p) Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha;
- q) Universiteti Politeknik i Tiranës (me ftesë);
- r) Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare;
- rr) Agjencia e Kombëtare e Mjedisit;
- s) Agjencia Kombëtare e Pyjeve;
- sh) Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake;
- t) Instituti i Ndërtimit (me ftesë);
- th) Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG);
- u) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha;
- v) Universiteti Bujqësor i Tiranës (me ftesë);
- x) Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH);
- xh) Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE);
- y) Enti Kombëtar i Banesave (me ftesë);

z) Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (me ftesë).

Niveli i përfaqësimit në KTK është drejtues ose specialist, i cili, në ushtrimin e detyrës së tij, ka kompetenca për çështjet e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore të institucionit apo të strukturës që përfaqëson.

3. Mënyra e funksionimit të Komisionit Teknik Këshillimor është, si më poshtë vijon:

a) KTK-ja thirret dhe drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sa herë që ai e gjykon të nevojshme, por jo më pak se një herë në gjashtë muaj;

b) Në varësi të nevojave, në mbledhjet e KTK-së ftohen edhe përfaqësues nga institucione shkencore dhe monitoruese, organizatave joqeveritare etj.;

c) Drejtori i AKMC-së për çështje specifike, sipas rastit, mund të thërrasë një pjesë të anëtarëve të KTK-së;

ç) Pranë KTK-së funksionon sekretaria teknike, me punonjës të AKMC-së, e cila përgjigjet për përgatitjen e materialeve dhe për njoftimin për mbledhjen e radhës së komisionit, duke ia dërguar çdo anëtar, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes.

4. Komisioni Teknik Këshillimor ka përgjegjësi:

a) të shqyrtojë strategjitë, politikat, programet dhe planet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit;

b) të shqyrtojë dhe të rekomandojë për çështjet që lidhen me programet e edukimit/arsimimit për strukturat e sistemit të mbrojtjes civile dhe publikun e gjerë në fushën e mbrojtjes civile;

c) të shqyrtojë dhe të analizojë planet për emergjencat civile, të përgatitura nga institucionet shtetërore e joshetërore, dhe të japë rekomandimet përkatëse, sipas rastit;

ç) të ndihmojë në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes civile, vënien në eficiencë të plotë të tij, përcaktimin e prioriteteve, si dhe identifikimin e nevojave;

d) të kontribuojë në rrugët e zgjidhjes për masat parandaluese, të rehabilitimit dhe të rimëkëmbjes për lloje të ndryshme fatkeqësish natyrore ose fatkeqësi të tjera;

dh) të shqyrtojë ose të vlerësojë studime në fushën e mbrojtjes civile.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, institucionet e përmendura në pikën 2, të vendimit dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe